



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1386/1 Prot.

Tiranë, më 16. 12. 2023

V E N D I M

**Nr. 255, datë 26. 12. 2023**

Bazuar në nenin 32/1/b dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 271 Regj., datë 20.12.2023<sup>1</sup>, të Organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022”, kundër Federatës Shqiptare të Notit, në të cilën pretendohet për diskriminim për “shkak të përgjegjësisë prindërore<sup>2</sup>” dhe “çdo shkak tjetër”<sup>3</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, Organizata “Future Sports Academy Shkodër 2022”, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pretendon ndër të tjera se: “Nga momenti i regjistrimit si shoqatë sportive pranë Gjykatës Tiranë, kemi dërguar dokumentacionin e kërkuar nga Federata Shqiptare e Notit për tu bërë pjesë e kësaj Federate. Më datë 26 Prill 2022 kemi dërguar zyrtarisht (me email) kërkesën për tu bërë pjesë e Federatës e në të njëjtën kohë i kemi kërkuar shpejtimin e procedurave për tu bërë pjesë e Federatës me qëllim dhe marrjen pjesë në garat e datës 13 Maj 2022 që Federata organizonte. Nga ai moment e deri sot që flasim vetëm zvarritje të procesit të ligjshëm të anëtarësimit tonë dhe diskriminim total i të drejtave ligjore për ushtrimin e sportit të notit në aktivitetet e organizuara nga kjo Federatë (përfshij këtu aktivitetin e vjetshëm në kujtim të sportistit K. M., që na u lejua pjesëmarrja falë ndërhyrjes së z. B. M., i ati i të ndjerit K. M. )”.

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri, ndalimin e diskriminimit nga ana e Federatës Shqiptare të Notit.

<sup>1</sup> Plotësuar nga pala ankuese nëpërmjet e-mailit datë 21.12.2023.

<sup>2</sup> Në përmbushjen e gjitha detyrimeve si prind karshi fëmijëve të mi duke mu cenuar rëndë përgjegjësia prindërore.

<sup>3</sup> Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon a justifikon ankuesi me këtë shkak.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektin nga i cili pretendon se diskriminohet.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 20.12.2023, KMD, i ka kërkuar Organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022”, të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike, subjekti ankues, më datë 21.12.2023, ka sqaruar ndër të tjera se: *“Ju them se përveç pikës së zgjedhur në ankesën e bërë jam në kushtet e diskriminimit edhe sipas pikës 19-Përgjegjësia prindërore, si prind i dy fëmijëve të mitur të cilëve u privohet e drejta e tyre Kushtetuese për të ushtruar lirisht sportin e notit në Republikën e Shqipërisë e për t’ju njohur çdo arritje, në rastin konkret thyerja e Rekordit Kombëtar për moshat 12 vjeçare në disiplinën 50 metër not shpinë në pishinë 50 metërshe.*

*Në garat Ndërkombëtare të zhvilluara me datë 10 Qershor 2023 në Nikshiq të Malit të Zi, turneu “Young Hopes 2023” A. H., djali im i vogël theu rekordin kombëtar për pishina 50 metër në disiplinën not shpinë 50 metër me rezultatin 34.95, rekord i vendosur më parë nga G. K. në një turne ndërkombëtar të zhvilluar në Berlin në datat 17-19 Dhjetor 2016 me rezultatin 36.80 sekonda (burimi [fshn.gov.al](http://fshn.gov.al), faqja zyrtare e Federatës Shqiptare të Notit dhe bashkëlidhur listat e rekordeve ku nga momenti i kërkesës së bërë për njohje rekordi, rekordet për pishina 50 metërshe u hoqën nga faqja zyrtare e sot me datë 21 Dhjetor në këtë faqe nuk dalin, ndërsa rekordet për pishina 25 metërshe dalin me printscreen të dyja), por për fat të mirë unë e kam këtë listë të rekordeve në pishina 50 metërshe e kam dhe dhe po e dërgoj.*

*Kam kërkuar njohjen dhe publikimin e këtij rekordi individual në faqen zyrtare të Federatës Shqiptare të Notit si sportisti i parë Shkodran i viteve të fundit që e ka vendosur një Rekord Kombëtar dhe kam dorëzuar këto dokumenta që po ju dërgoj dhe juve....*

*Sa më lart dhe bashkëlidhur unë ndihem i diskriminuar në përmbushjen e gjitha detyrimeve si prind karshi fëmijëve të mi duke mu cenuar rëndë përgjegjësia prindërore”.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare\_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përbashkëtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, fillimisht është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Më pas subjekti ankues ka shtuar faktin se është diskriminuar nga ana e Federatës Shqiptare të Notit për shkak të përgjegjësisë prindërore. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të organizatës.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e palës ankuese për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm nga Federata Shqiptare e Notit, vijnë për shkaqet e pretenduara, duhet që fillimisht këto shkaqe të jenë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkaqe të njohura nga LMD.

Së pari, sa i takon pretendimit të palës ankuese për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh<sup>5</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh<sup>6</sup>.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi<sup>7</sup> karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të

---

<sup>5</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

<sup>6</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

<sup>7</sup> “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën pala ankuese nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së dyti, bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të Ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe në kërkesat e përcaktuara në formularin e aplikimit, në rastin kur ankesa paraqitet nga një organizatë me interesa legjitime, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopja e vendimit të gjykatës për krijimin e organizatës, kopja e statutit të organizatës dhe kopja e kartës së identitetit.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, evidentohet se për legjitimitimin e Organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022”, përpara Komisionerit, nga pala ankuese është paraqitur kopje e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e qendrës në gjykatë, kopje e aktit të themelimit, si dhe kopje të statutit të organizatës.

Nga analiza e bërë vendimit të gjykatës, rezulton se ai mban datën 07.03.2022 dhe citon se: *“...Mënyra e organizimit, funksionimit dhe kompetencat e këtyre organeve janë përcaktuar qartë në statutin e shoqatës...Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës “Future Sports Academy Shkodër 2022” është z. A. L...”*. Ndërsa, në pikën ku referohet *“Drejtori Ekzekutiv i Organizatës”* në Statutin e Shoqatës citohet se: *“1. Drejtori Ekzekutiv është organi ekzekutiv më i lartë i organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022”*. Në pikën *“Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv”*, citohet se: *“...4. Përfaqëson organizatën “Future Sports Academy Shkodër 2022” në marrëdhënie me palë të tjera;”*.

Gjithashtu, në Aktin e Themelimit, në pikën *“Përfaqësimi i organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022””*, citohet se: *“Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022”, në marrëdhënie me subjektet private ose publike, organeve gjyqësore, donatorë, klientë, furnizues apo subjekte të tjera private në R.Sh. dhe jashtë saj, si dhe me të gjitha nivelet e qeverisjes në R.Sh. që rregullojnë veprimtarinë e organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022””*.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Nga aktet e administruara rezulton se, Organizata *“Future Sports Academy Shkodër 2022”* është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendim nr. 6856, datë 07.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Organizata *“Future Sports Academy Shkodër 2022”* pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, lidhur me zvarritjen e procedurave dhe procesin e anëtarësimit të të saj në Federatën Shqiptare të Notit.

Subjekti ankues, Organizata *“Future Sports Academy Shkodër 2022”*, pas kërkesës së KMD-së për të saktësuar e provuar shkakun për të cilin pretendon diskriminimin, në vijim ka shtuar shkakun e përgjegjësisë prindërore.

Referuar Statutit të Organizatës *“Future Sports Academy Shkodër 2022”*, evidentohet se Kryetar i Bordit të saj, rezulton të jetë G. H. Pas plotësimit të ankesës, gjatë shqyrtimit paraprak të saj, pretendohet se si shkak diskriminimi, është përgjegjësia prindërore e G. H., duke theksuar se: *“si prind i dy fëmijëve të mitur të cilëve u privohet e drejta e tyre Kushtetuese për të ushtruar lirisht sportin e notit në Republikën e Shqipërisë e për t'ju njohur çdo arritje, në rastin konkret thyerja e Rekordit Kombëtar për moshat 12 vjeçare në disiplinën 50 metër not shpinë në pishinë 50 metërshe”*.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet



nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

*“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”<sup>8</sup>”*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e

<sup>8</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, pala ankuese ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim nga ana e subjektit kundër të cilit ajo ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, Federatës Shqiptare të Notit, duke pretenduar se zvarritja e procedurave dhe procesit të anëtarësimit të saj në këtë Federatë, situatë e cila supozohet se ka si shkak i përgjegjësinë prindërore të G. H.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkakun e sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të paraqtojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është përgjegjësia prindërore.

Në këtë kuptim, shkakun i pretenduar i diskriminimit është në karakteristikë/veçori që e mbart G. H. dhe jo Organizata “Future Sports Academy Shkodër 2022”, në të cilën ai bën pjesë.

Në kuptim të LMD-së, “Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.<sup>9</sup>”, ku lidhur me kuptimin e provueshmërinë e “përgjegjësisë prindërore”, cilësohet si më poshtë citojmë:

*“17. Përkatësia prindërore, nënvizon faktin se diskriminimi mund të ndodhë kundrejt një personi duke e identifikuar atë me prindërit e tij/saj, apo me statusin e prindërve të tij. Për këtë arsye dikush diskriminohet, jo për një shkak të mbartur nga ai vetë, por për një shkak që identifikohet me përkatësinë e tij prindërore. Këtu përfshihet edhe prejardhja, veçanërisht lidhur me përkatësinë në një shtresë sociale apo çdo lloj statusi të trashëguar<sup>10</sup>.”*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i Organizatës “Future Sports Academy Shkodër 2022”, për diskriminim për shkak të “përgjegjësisë prindërore” dhe “çdo shkak tjetër”, nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej palës ankuese. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se përgjegjësia prindërore nuk është një karakteristikë, apo veçanti që mbart Organizata “Future Sports Academy Shkodër 2022 dhe që prezumohet që ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar, por është një cilësi e pretenduar nga ana e G. H. pjesë e organizatës. Për të pretenduar diskriminim, pala ankuese, Organizata “Future Sports Academy Shkodër 2022” duhet të provojë faktin e ajo mbart një

<sup>9</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

<sup>10</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>



karakteristikë, apo veçanti krahasuar me organizatat e tjera pjesëmarrëse në Federatën Shqiptare të Notit dhe jo veçantinë e një prej anëtarëve të saj, pretendime të cilat nuk lidhen me trajtimin e disfavorshëm të organizatës por me cilësinë e personit, G. H.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkaqet e pretenduara, mbi të cilat të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse ajo është trajtuar në mënyrë të diferencuar nga anëtarët e tjerë të Federatës Shqiptare të Notit, lidhur me anëtarësimin në të, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga përgjegjësia prindërore e G. H.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se:

*“4. Ankesa nuk pranohet nëse: .....ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pikat 2, 4/ç të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues Organizata “Future Sports Academy Shkodër 2022”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Përgjegjësia prindërore)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)